

AKT THEMELIMI

i Shoqerise "Dental Connect" sh.p.k.

Sot me date 24/10/2025

Drilon Cela, atesia Afrim, lindur ne Polican me 06.02.2002, banues ne Tirane, Rr. Nasi Pavllo, Nd. nr.1, Hyrja 4, Nj. Bashkiake numer 2 Tirane, me Leternjoftim ID Nr. personal K20206004L.

me cilesine e ortakut themelues;

Mbeshtetur ne Ligjin nr. 9901 date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" me ndryshimet,

Ligjin Nr. 9723 date 03. 05. 2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" te ndryshuar, themelon shoqerine tregtare, me pergjegjesi te kufizuar, te emertuar:

" Dental Connect " sh. p. k.

KREU I

NENI 1

KRIJIMI

Shoqeria "**Dental Connect**" shpk eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur Shoqeria).

NENI 2

PERSONALITETI JURIDIK

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jete regjistruar ne QKB ne perputhje me kushtet e procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria pasi te kete fituar personalitetin juridik, eshte pergjegjese ndaj te treteve per detyrimet dhe demet e shkaktuara gjate veprimtarise se saj.

Kapitali i Shoqerise eshte kontribut i ortakut te shoqerise dhe perballon humbje deri ne kufirin e vleres se kontributit te ortakut ne kapitalin themeltar.

NENI 3

SELIA

Shoqeria e ka seline ne adresen: Tirane, Rr. Abdyl frasheri, Pallat. 3, Kati I 3.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale, si brenda dhe jashte Republikes se Shqiperise, me vendim te Asamblese se Ortakeve.

NENI 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Ne fushen e sherbimeve: Ofrimi i sherbimit te ndermjetesimit, konsulences ne sektorin e turizmit mjeksor e atij dentar, mbeshtetje dhe koordinim ne komunikimin mes paleve, asistence lidhur me nevoja te tjera ne funksion te realizimit te sherbimit. Shoqeria mund te ushtroje cfaredolloj aktiviteti tjeter per cfaredolloj natyre qe nuk eshte ne kundershtrim me legjislacionin shqiptar ne fuqi pa asnje kufizim .

NENI 5

KOHEZGJATJA

Shoqeria do te zhvilloj aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar, pa afat.

KREU II

KAPITALI

NENI 6

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke.

Kapitali mesiperm eshte nenshkruar nga ortaku i shoqerise.

Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

NENI 7

TRANSFERIMI I KAPITALIT

Pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave te trete, qe nuk bejne pjese ne shoqeri, me miratimin e Ortakeve te Shoqerise sipas menyrave te vendimmarrjes te percaktuar ne legjislacionin ne fuqi.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie. Ato Jane lirisht te transferueshme edhe ne rast ndarjeje pasurore mes bashkeshorteve.

Gjithashtu jane lirisht te transferueshme ndermjet bashkeshorteve, si dhe ndermjet paraardhesve dhe pasardhesve.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

NENI 8

ORGANI VENDIMMARRES

Asambleja e ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi vendimmarres i shoqerise, qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara me ligj.

Asambleja e ortakeve brenda nje afati prej gjashte muajsh, duke filluar nga data e mbylljes se vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogarite vjetore, te hartuara nga administratori.

NENI 9

NDRYSHIMET E STATUTIT

Ndryshimet e statutit vendosen nga Asambleja e ortakeve

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

NENI 10

ADMINISTRIMI

Administrator i shoqerise eshte emeruar Drilon Cela.

Administratori ushtron funksionin e tij per nje periudhe kohe 5 vjecare qe nga momenti i emerimit, me te drejte riemerimi.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakeve te Shoqerise.

NENI 11

KOMPETENCAT Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave, qe ligji i jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Adiministratori angazhon shoqerine ne maredheniet me te tretet nepermjet akteve, qe jane ne perputhje me objektin e saj. Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve, kur ajo provon se te tretet e dinin, qe akti i administratorit e kalonte objektin e shoqerise ose kur te tretet nuk mund te injoronin kete akt ne rrethanat e dhena duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme .

Administratorit nuk i lejohet te marre hua te shoqeria, te jape pelqimin ne emer te saj per paradhenie si Dhe te behet dorezenes ndaj te treteve. Ne rast te kundert kontrata eshte e pavlefshme.

Klauzolat e ketij statusi, qe kufizojne kompetencat e administratorit, te cilat rrjedhin nga ky nen, duhet te respektohen nga te tretet.

NENI 12

VITI FINANCIAR

Viti financiar i shoqerise fillon me 01 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e rregjistrimit te shoqerise ne QKR dhe mbyllet ne 31 Dhjetor.

NENI 13

SHPERNDARJA, PRISHJA E SHOQERISE

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe dhe per cfaredo shkak, plotesimit te afatit per te cilen eshte krijuar sic mund te jene:

Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimet te metejshe te veprimtarise se saj.

Ne nje nga menytrat e parashikuara nga ligji 'Per falementimin e Shoqerise Tregtare'

Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e vepromtarise tregtare.

Me vendimin e Asamblese se Ortakeve.

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilen parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise duke caktuar 1(nje) ose disa likuidatore dhe shenuar ne cdo document te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesin shtese 'Shoqeri ne likujdim'.

NENI 14

BAZA LIGJORE

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat ligjore ne fuqi dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

NENI 15

DISPOZITA PERFUNDIMTARE

Ky akt themelimi u redaktua ne 3 kopje me permbajtje te njejta, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet nga ortakut themelues, nenshkruhet ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe nenshkrimin e tij sipas ligjit.

Tirane me date 24/10/2025

ORTAKET

Drilon CELA

